

# STATUTI

## I Shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "GJOKA Soft" shpk

Persohi që firmos si me poshtë:

- Hegi GJOKA lindur me date 16.01.1997, ne Berat dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtes i dokumentit të identifikimit me ID, J70116067N.

Në baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare ", krijojne Statutin e ketij subjekti, perkatesisht Shoqërise.

### **KREU 1**

#### **Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.**

##### **Neni 1**

**Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.**

- (1) Sot me date 17.02.2024, themeluesi, Hegi GJOKA, ka vendosur, të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ne përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, sipa Ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare", dhe aktet e tjera nënligjore që jane ne fuqi. Shoqëria është një person juridik Shqipëtar, i cili do të ushtrojë aktivitetin privat ne Territorin e Republikës se Shqipërisë, pas regjistrimit ne QKB.
- (2) Themelues i Shoqërise është;
  - Hegi GJOKA, me ID nr J70116067N, atësia Novruz, i datëlindjes 16.01.1997, me adrese Njesia Bashkiake nr 14, Unaze e Re, Tirane.

##### **Neni 2**

###### **Emërtimi**

Emri i Shoqërise është "GJOKA Soft" shpk

##### **Neni 3**

###### **Objekti**

Zhvillues i sistemeve dhe programeve Software dhe mirembajtja e tyre.

##### **Neni 4**

###### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërise, do te jete e pakufizuar. Ajo mund te Shpërbehet ne çdo kohe me vendim te asamblese se Ortakeve

##### **Neni 5**

###### **Selia**

- (1). Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresen; Rr "Sabri Preveza", Kompleksi GORA, Nd 14, Ap 2, Kati perdhe, Unaze e Re, Tirane.
- (2) Adresa e faqes zyrtare te Internetit eshte: hgjoka16@gmail.com.
- (3) Adresa e Shoqërise, per qellime komunikimi elektronik ( nese ka ) eshte si vijon

**Neni 6**

Shoqëria ka Vullen e saj ku janë të percaktuara inicialet e emertimit të saj, NIPT-i dhe adresa baze.

**KREU II**

**Kapitali**

**Neni 7**

**Kapitali Themeltar**

Kapitali fillestar, njekohesisht dhe Kapital Themeltar i Shoqërisë është; 1000000 (njemilion) leke, perkatesisht në një kuotë me vlerë nominale 1000000 leke. Kapitali Themeltar përbëhet nga kontribute në vlerë monetare në shumën 1000000 leke.

**Neni 8**

Pjesëmarrja e themeluesve në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë është në përputhje me kontributet e mëposhtme;

- Ortaku Hegi GJOKA, zotëruar i 1 ( një ) kuotë me vlerë të përgjithshme, 1000000 leke, që përbën 100 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

**Neni 9**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit.**

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe kontributet në natyrë, gjë e cila arrihet nepermjet emërimit në rrugë ligjore të një eksperti të autorizuar, për këto kontribute sipas kërkesës së paraqitur nga një person i autorizuar nga të gjithë ortakët.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin e Shoqërisë.

Zvogëlimi i Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 10**

**Transferimi i Kapitalit**

Kuotat e Kapitalit në një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit në kapitalin e Shoqërisë
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut.

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **Organet vendimarrëse dhe drejtuese**

#### **Neni 11**

##### **Organet Vendimarrëse**

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme;

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel të Autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorët, Likujduesit dhe Ekspertët Kontabel të Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve për ecurinë e veprimtarisë.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqësimin e Shoqërisë në Gjykatë të të gjitha niveleve si dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Perfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- Miratimin e rregullave procedurale për thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve të Asamblese së Ortakeve.
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Një Ortak mund të perfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve, në bazë të një autorizimi, nga një Ortak Tjetër, apo një person i tretë.

Administratori I Shoqërisë ( në rastin kur nuk është Ortak ), nuk mund të veprojë si perfaqësues I ortakeve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi I perfaqësimit mund të jepet vetëm për një mbledhje asambleje të përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 12**

##### **Menyra e thirrjes së Mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve**

- (1) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit me shkresë ose, nëse parashikohet nga Statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë, apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë; vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Ky njoftim duhet t'u dërgohet të gjithë ortakeve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.

- (2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, për te marre vendime pavarsisht parregullsise.

### **Neni 13**

#### **Kuorumi**

- (1) Në rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 ( tridhjetë ) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Per tregetarët dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 14**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicene votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
  - b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
  - c) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar,
  - d) Percaktimin e shperblimeve,
  - e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
  - f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
  - g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
- Cdo ndryshim statute duhet t e depozitohet ne QKR duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 15**

#### **Përfundimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
  - a) Vleresimin e veprimtarise se tij,
  - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
  - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
  - d) Dhenjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, I autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.



## **Neni 16** **Administrimi**

- (1) Asambleja e pergjithshme emerohet nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati I emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripercaktim. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas. Cdo emerim I bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte I pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat)

dhe specififikimet e nenshkrimet:

\_\_\_ Hegi GJOKA \_\_\_\_\_ me ID J70116067N \_\_\_\_\_

Atesia;        I lir

Datelindja: 16.01.1997, me adrese; Njesia Bashkiake nr 14, Tirane.

## **Neni 17** **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqërise, doke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Përfaqesojne Shoqerine tregtare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- d) Përgatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siç parashikohet ne Ligjin per Qëndren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportoje perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise tregtare.
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të paktën 20 % të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- Shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë me të paktën 20 % të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme, mund të shkurtojë administratorin, në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore të punës, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 18**

### **Përgjegjësia e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për fajet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja, që i sjellin dem Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatëse.

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet;
  - a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara me ligj dhe në statut, me mirëbesim e në interesin me të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.
  - b. Të ushtrojë kompetencat që i njohën me ligj dhe me Statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
  - c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.
  - d. Të parandalojë dhe menjajtojë rastet e konfliktit, prezent, apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë.
  - e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë Tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve perkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer me mirëbesim.
3. Nëse, Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshpërblejë Shoqërisë demet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal, që ata apo, personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt, e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundershkrim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare ", kryen veprimet e mëposhtme:

- U kthen ortakeve kontributet
- U paguan ortakeve interesa apo dividende
- U shperndan aktivet e Shoqerise
- Lejon qe Shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe Shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
- Jep kredi.

Përvec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te njeikin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i është shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar, nese është e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV**

#### **Viti financiar – ekspertet**

##### **Neni 19**

##### **Viti financiar**

Viti financiar i shoqerise fillon me date 1 janar dhe perfundon me date 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 20**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat është i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

##### **Neni 21**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,



d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve,brenda 20 diteve pas prishjes,cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

### **Neni 22**

#### **Riorganizimi I shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese së Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

### **Neni 23**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statutdhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te bazohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

### **Neni 24**

#### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqipetare.

## **ORTAKU I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **ORTAKU**

**Hegi GJOKA**

